



Nr. 362 prot
08/03/2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

URDHËR

Nr 87 datë 22/2 /2016

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT DHE PËRBËRJES SË KËSHILLIT
TEKNIK SHKENCOR TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe pikës 3, neni 11, të ligjit nr.111/2015, date 15.10.2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar" dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm,

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores së Funkcionimit te Këshillit Teknik Shkencor të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Minierave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
3. Rregullorja e mëparshme e Këshillit Teknik Shkencor të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI



RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TEKNIK SHKENCOR TË SHËRBIMIT
GJEOLGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 11, pika 3, të ligjit nr.111/2015 datë 15.10.2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”(ShGjSh), me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, miratoj këtë rregullore të Funkcionimit të Këshillit Teknik Shkencor të ShGjSh-së:

Neni 1

Në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar funksionon Këshilli Teknik Shkencor, që është strukturë vendimmarrëse dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 2

Këshilli Teknik Shkencor i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përbëhet nga 13 anëtarë të funksioneve dhe fushave të ndryshme që kanë përvojë dhe në nivel shkencor.

Neni 3

Këshilli Teknik Shkencor i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe në mungesë të tij nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm, zhvillon mbledhjet e tij periodike, si rregull jo më pak se një herë në tre muaj, me objekt kryesor analizën e rezultateve të realizimit të projekt-programeve zhvillimore e atyre ekonomiko-financiare të ShGjSh-së.

Neni 4

Detyrat e Këshillit Teknik Shkencor të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

1. Shqyrton dhe merr vendime për strategjinë, programet afatgjata, afatmesme dhe programet vjetore të zhvillimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
2. Shqyrton dhe merr vendime për vlerësimin e rezultateve të arritura nga projekt-programet e realizuara nëpërmjet raporteve studimore.
3. Shqyrton dhe merr vendime për projekte, relacione, studime dhe raporte që kryen Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, dhe të atyre që kryhen në bashkëpunim me të tretët vendas ose të huaj.
4. Shqyrton dhe merr vendime për Rregulloren e brendshme të ShGjSh-së, të drejtorive e njësisve të tjera në përbërje të strukturës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
5. Shqyrton e merr vendime për kërkesat dhe projektet e subjekteve të ndryshme, për pajisje me leje kërkim-zbulimi dhe miraton projektet e raportet përfundimtare të këtyre subjekteve.

Neni 5

Mbledhjet e Këshillit Teknik Shkencor

1. Mbledhjet e Këshillit Teknik Shkencor, fillojnë kur janë të pranishëm 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të tij.
2. Vendimet e Këshillit Teknik Shkencor, merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje, kur votat janë të barabarta vendos vota e Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Mbledhje e Këshillit Teknik Shkencor, dokumentohet me protokoll përkatës, ku në përfundim të çdo mbledhje, firmos çdo anëtar i pranishëm.

4. Vendimet e Këshillit Shkencor, firmosen nga Sekretari i Këshillit dhe Kryetar i tij, që është Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në mungesë të tij nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 6

Shpërblimi i anëtareve të Këshillit Teknik Shkencor përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Rregullorja e funksionimit të Këshillit Teknik të ShGjSh-së që ishte në fuqi deri tani, shfuqizohet.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

